

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CI.GR.HY. Circular Green Hydrogen” SHPK

Ortakët themelues:

- **Z. Massimo Guerra**, shtetas italian, i datëlindjes 05/06/1951, lindur në Romë (RM), banues në Rrugën Spinoza, nr.71, 00137, Romë, Itali, madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës italiane Nr. YA9925621
- **Z. Vincenzo Naso**, shtetas italian, i datëlindjes 10/11/1944, lindur në Napoli (NA), banues në Rrugën Tommaso Grossi, nr.6, 00184, Romë, Itali, madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës italiane Nr. YA9386854
- **Z. Francesco Di Pietrantonio**, shtetas italian, i datëlindjes 14/09/1950, lindur në Ascoli Piceno (AP), banues në Rrugën Faragone, nr.12, 64010, Ancarano (TE), Itali, madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit italiane Nr. AY9019303
- **Z. Luigino Malavolta**, shtetas italian, i datëlindjes 15/11/1963, lindur në Castel di Lama (AP), banues në Rrugën Monte Sibilla, nr.25, Ascoli Piceno (AP), Itali, madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit italiane Nr. CA38309HV
- **Z. Giulio Bavastrelli**, shtetas italian, i datëlindjes 28/04/1947, lindur në Barcelona Pozzo di Goto (ME), Rruga Libia, nr.38, PI.7, IN.19, Romë, Itali, madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit italiane Nr. AY9067153

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 10.10.2024, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1
Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**CI.GR.HY. Circular Green Hydrogen**” shpk

Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2
Forma

Shoqëria tregtare “**CI.GR.HY. Circular Green Hydrogen**” shpk ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.



NENI 3
Zyra Qendrore

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**CI.GR.HY. Circular Green Hydrogen**” shpk, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqipëri.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Zhvillim, prodhim, marketing, asistencë teknike dhe mirëmbajtje të impianteve, pajisjeve dhe teknologjive të qëndrueshme të bazuara në Energji të rinovueshme;
- Kërkimi i Aplikuar dhe Transferimi i Teknologjisë;
- Trajnime, Trajnime për Arsim të Lartë, shpërndarja e njohurive dhe principeve të Ekonomisë Qarkulluese dhe Shkencës së Qëndrueshmërisë;
- Studime dhe aplikime akademike, industriale dhe komerciale të Shkencës së Qëndrueshmërisë;
- Botime multimedia në letër, në internet ose në DVD, ose formate të ngjashme.

NENI 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare “**CI.GR.HY. Circular Green Hydrogen**” shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “**CI.GR.HY. Circular Green Hydrogen**” shpk.

Përgjegjësia e ortakëve është e kufizuar në vlerën e aksioneve që ata kanë kontribuar në shoqëri.



NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**CI.GR.HY. Circular Green Hydrogen**” shpk është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakët e ndarë në 5 pjesë:

- **Z. Massimo Guerra** – 1 kuotë – 30% me vlerë 30.000 (tridhjetë mijë lekë);
- **Z. Vincenzo Naso** – 1 kuotë – 30% me vlerë 30.000 (tridhjetë mijë lekë);
- **Z. Francesco Di Pietrantonio** – 1 kuotë – 23% me vlerë 23.000 (njëzet e tre mijë lekë);
- **Z. Luigino Malavolta** – 1 kuotë – 7% me vlerë 7.000 (shtatë mijë lekë);
- **Z. Giulio Bavastrelli** – 1 kuotë – 10% me vlerë 10.000 (dhjetë mijë lekë).

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria drejtohet nga një Bord Drejtues, i emëruar dhe revokuar nga Asambleja e Përgjithshme. Mandati për këtë emërim është 3 vjet, me të drejtë rinovimi.

Këshilli i parë përbëhet nga **Z. Massimo Guerra - president;**

Z. Vincenzo Naso - këshilltar;

Z. Francesco Di Pietrantonio – këshilltar.

NENI 11

Sekretit tregtar

Ortakët, administratorët dhe punëmarrësit e shoqërisë “**CI.GR.HY. Circular Green Hydrogen**” shpk përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12

Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim.

Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Massimo Guerra

Massimo Guerra

Z. Vincenzo Naso

Vincenzo Naso

Z. Francesco Di Pietrantonio

Di Pietrantonio Francesco

Z. Luigino Malavolta

Luigino Malavolta

Z. Giulio Bavastrelli

Giulio Bavastrelli